



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.30

2004

19 maj

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9217 datë 8.4.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8576, datë 3.2.2000 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë"..... 2507
Ligj nr.9218, datë 8.4.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre"..... 2509
Ligj nr.9219 datë 8.4.2004	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7875, datë 23.11.1994 "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë"..... 2514
Vendim i Kuvendit nr.129, datë 15.4.2004	Për caktimin e pagës së anëtarëve dhe kryetarit të Bordit të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE)..... 2518
Vendim i Kuvendit nr.130, datë 15.4.2004	Për caktimin e pagës së anëtarëve dhe kryetarit të Komisionit të Konkurrencës..... 2518
Vendim i Kuvendit nr.131, datë 19.4.2004	Për Komisionin Hetimor Parlamentar për hetimin në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare..... 2519
Vendim i KM nr.270, datë 7.5.2004	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Komitetit Shtetëror të Minoriteteve të disa mjediseve, për ushtrimin e veprimtarisë së këtij Komiteti..... 2520

Vendim i KM nr.272, datë 7.5.2004	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federative të Brazilit, për heqjen e pjesshme të vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare ose të shërbimit.	2520
Vendim i KM nr.279, datë 16.4.2004	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Tiranës.....	2522
Vendim i KM nr.280, datë 16.4.2004	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Durrësit.....	2523
Vendim i KM nr.282, datë 16.4.2004	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Shkodrës	2524
Vendim i KM nr.283, datë 16.4.2004	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Lezhës.....	2525
Vendim i KM nr.284, datë 16.4.2004	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Krujë-Kurbin	2526
Vendim i KM nr.285, datë 16.4.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.490, datë 16.10.2002 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e bordit të kullimit të rrethit Kavajë”	2527
Vendim i KM nr.286, datë 16.4.2004	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Elbasanit.....	2527
Vendim i KM nr.287, datë 23.4.2004	Për lejimin e institucioneve buxhetore të përdorin procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë” për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të tyre motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.	2528
Vendim i KM nr.288, datë 16.4.2004	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Fierit.....	2529
Vendim i KM nr.289, datë 16.4.2004	Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Vlorës.....	2530
Vendim i KM Nr.290, datë 30.4.2004	Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota.....	2531
Udhëzim i ME nr.5, datë 19.1.2004	“Për monitorimin e kontratave të qirave dhe enfiteozës, vlerësimin e investimeve në objektet e ndërmarrjeve, shoqërive apo institucioneve shtetërore, të dhëna me qira ose enfiteozë, monitorimin e tyre dhe aplikimin e koeficientëve të uljes së çmimit të qirasë”	2531
Rregullore e ME	Mbi detyrat, kompetencat dhe funksionimin e degëve të shoqërive publike pranë prefekturave.....	2533

LIGJ
Nr.9217, datë 8.4.2004

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8576, DATË 3.2.2000 "PËR
BIBLIOTEKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8576, datë 3.2.2000 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në fjalinë e fundit të nenit 2 fjala "të formimit" hiqet.

Neni 2

Shkronjat "a", "c" dhe "ç" të nenit 7 ndryshohen si më poshtë:

"a) të marrë të dhëna për koleksionet e bibliotekës dhe për koleksionet e bibliotekave të tjera nëpërmjet mjeteve të informacionit bibliotekar;

c) të shfrytëzojë koleksionet e bibliotekës dhe të huazojë materiale bibliotekare, sipas rregullores së bibliotekës;

ç) të huazojë materiale nga bibliotekat e tjera, brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet shërbimit ndërbibliotekar, sipas rregullores së saj."

Neni 3

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8

E drejta për shërbim dhe informacion bibliotekar sigurohet falas dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë përdoruesit e bibliotekave.

Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të bibliotekës përcaktohen në rregulloret e brendshme, të cilat miratohen nga drejtuesit e bibliotekave. Tarifat për shërbime të veçanta të ofruara në biblioteka përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi."

Neni 4

Pika 1 e nenit 13 ndryshohet si më poshtë:

"1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve drejton dhe mbikëqyr standardet profesionale në të gjithë rrjetin bibliotekar të vendit nëpërmjet Bibliotekës Kombëtare, si qendër e kualifikimit profesional në nivel kombëtar."

Neni 5

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14

Pranë Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve funksionon Këshilli Kombëtar i Bibliotekave, si organ këshillimor i ministrit. Këshilli mbledhet jo më rrallë se dy herë në vit.

Këshilli Kombëtar i Bibliotekave përbëhet nga:

- 2 përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, anëtarë;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, anëtar;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, anëtar;
- 1 përfaqësues nga Akademia e Shkencave, anëtar;
- 1 përfaqësues nga Shoqata e Punonjësve të Bibliotekave, anëtar;
- 1 përfaqësues nga Biblioteka Kombëtare, anëtar;
- 1 përfaqësues nga bibliotekat publike, anëtar;
- 1 përfaqësues nga bibliotekat e veçanta, anëtar;
- 1 përfaqësues nga bibliotekat universitare, anëtar;
- 1 përfaqësues nga çdo shoqatë botuesish, anëtar;
- 1 përfaqësues nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, anëtar.

Këshilli Kombëtar i Bibliotekave shqyrton çështje që kanë të bëjnë me:

- analizën e gjendjes së sistemit bibliotekar dhe dhënien e rekomandimeve për zhvillimin e tij;
- bashkërendimin e veprimtarive të këtij sistemi, politikat e pasurimit, huazimit ndërbibliotekar, katalogët përmbledhës etj.;
- orientimin e përgatitjes dhe të trajnimit të të gjithë bibliotekarëve;
- rekomandimin e normave dhe të standardeve për zhvillimin e veprimtarisë bibliotekare.

Funksionimi i Këshillit Kombëtar të Bibliotekave përcaktohet në rregulloren e tij të brendshme, e cila miratohet nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në rregullore përcaktohen mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të përfaqësuesve në Këshillin Kombëtar të Bibliotekave, organizimi dhe funksionimi i tij, si dhe mënyra e shpërblimit të anëtarëve."

Neni 6

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 21

"Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve miraton statutet tip të të gjithë sistemit të bibliotekave, si dhe me propozimin e drejtuesit të Bibliotekës Kombëtare miraton statutin e këtij institucioni, me përjashtim të bibliotekave universitare, statuti i të cilave miratohet nga rektori me propozimin e drejtuesit të bibliotekës universitare.

Kontrolli metodik-shkencor dhe standardet teknike të punës, për të gjithë sistemin e bibliotekave, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve."

Neni 7

Në paragrafin e tretë "Bibliotekat publike, vendore" të nenit 26, fjala "vendore" hiqet.

Neni 8

Në nenin 27 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

"8. Drejton, organizon dhe kryen trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve të bibliotekave të vendit."

2. Në paragrafin e parë të pikës 11, pas fjalës "e restaurimit" shtohen fjalët "dhe konservimit".

3. Paragrafi i dytë i pikës 11 ndryshohet si më poshtë:

"Biblioteka Kombëtare bën blerje dhe huazime ndërkombëtare të materialit bibliotekar me fondin e veçantë buxhetor, të dhënë çdo vit kalendarik nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve."

Neni 9

Në nenin 28 bëhen këto ndryshime:

1. Fjala "vendore" hiqet.

2. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

"10. Bibliotekat publike, me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të përbashkët të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, kategorizohen në tri nivele, në varësi të koleksioneve, numrit të përdoruesve dhe të shërbimeve bibliotekare që ofrojnë."

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4220, datë 5.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ

Nr.9218, datë 8.4.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8450, DATË 24.2.1999 "PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 9, pas pikës 2 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Duke filluar nga viti 2007 deri në vitin 2010 rezerva e sigurisë do të jetë e barabartë me 60 ditë mesatare shitjeje, ndërsa nga viti 2010 e në vazhdim rezerva e sigurisë do të jetë e barabartë me 90 ditë mesatare shitjeje."

Neni 2

Në nenin 11 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën "ç", pas fjalëve "veprimtarinë e tregtimit të karburanteve" shtohen fjalët "gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante".

2. Në fillim të shkronjës "d" shtohen fjalët "Stacionet dhe", ndërsa fjala "ngrohje" zëvendësohet me fjalët "përdorim rezidencial".

Neni 3

Pas nenit 12 shtohet neni 12.1 me këtë përmbajtje:

"Neni 12.1

Implantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës

1. Implantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës janë persona juridikë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi, që ushtrojnë veprimtari në fushën e ripërpunimit të nënprodukteve të naftës, për të prodhuar nënprodukte të reja.

2. Ndërtimi dhe funksionimi i impianteve të përpunimit të nënprodukteve të naftës bëhen pasi ato të jenë pajisur me "Leje përpunimi", sipas procedurave dhe kushteve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Implantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës e zhvillojnë veprimtarinë e shitjes së prodhimeve të tyre vetë ose nëpërmjet një shoqërie tjetër tregtimi me shumicë, vetëm pas marrjes së lejes së tregtimit nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet.

4. Implantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës përgjigjen për markën e prodhimit dhe cilësinë e produkteve që prodhojnë.

5. Subjektet zotëruese të impianteve të përpunimit të nënprodukteve të naftës kanë të drejtë të themelojnë apo të marrin pjesë në shoqëritë, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me pakicë të prodhimeve të tyre."

Neni 4

Në nenin 14 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 7 shtohen fjalët "si dhe konsumatorët e mëdhenj industrialë (kombinate, fabrika dhe uzina)."

2. Pas pikës 10 shtohen pikat 11 dhe 12 me këtë përmbajtje:

"11. Shoqëritë anonime të pajisura me leje tregtimi, që ndryshojnë emrin e subjektit juridik, kanë të drejtë të bëjnë shtesa ose ndryshim kategorie, brenda të njëjtit lloj lejeje, duke respektuar afatin e lejes së mëparshme dhe duke plotësuar, për secilën kategori, kushtet dhe normat teknike, të vërtetuara nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre.

12. Futja në treg dhe përdorimi i pajisjeve nën presion, që shërbejnë për trajtimin dhe ambalazhimin e gazit të lëngshëm të naftës nga shoqëritë e tregtimit me shumicë të këtij nënprodukti (GLN), bëhet vetëm kur ato plotësojnë kërkesat e ligjit nr.8739, datë 12.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve nën presion". Shoqëritë e tregtimit me shumicë të gazit të lëngshëm të naftës bëjnë mbushjen e bombolave me këtë nënprodukt."

Neni 5

Në nenin 15, paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"Veprimtaria e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikante, ku përfshihen nënproduktet e kategorive I, II, III dhe IV/A, kryhet nga stacionet e shitjes së karburanteve. Me përjashtim të nënproduktit të kategorisë IV/A, nënproduktet e tjera tregtohen vetëm nëpërmjet aparateve të matjes dhe të regjistrimit të sasisë së shitjes. Stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikante ndalohen të mbushin bombola me gaz të lëngshëm për përdorim shtëpiak apo tregtar."

Neni 6

Në nenin 16 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

" Veprimtaria e tregtimit me pakicë të lëndëve djegëse për ngrohje dhe gatim për konsumatorët kryhet nga stacionet dhe njësitë e lëndëve djegëse.".

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Njësitë e tregtimit me pakicë të bombolave të gazit të lëngshëm të naftës janë të detyruara të respektojnë kushtet dhe rregullat teknike për përpunimin e këtyre bombolave, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 7

Në nenin 17, pas fjalëve "leje koncesioni" shtohen fjalët "leje përpunimi".

Neni 8

Në nenin 18, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Kushtet dhe procedurat për dhënien e lejeve të koncesionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 9

Pas nenit 18 shtohet neni 18.1 me këtë përmbajtje:

"Neni 18.1

Leja e përpunimit

1. Leja e përpunimit u jepet personave juridikë, të përcaktuar në shkronjën "a.1" të nenit 11 të këtij ligji, të cilët kryejnë veprimtarinë e përpunimit të nënprodukteve të naftës.

2. Leja e përpunimit jepet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, sipas kushteve dhe procedurave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

3. Lejet e përpunimit jepen për 20 vjet, me të drejtë rinovimi.".

Neni 10

Në nenin 20 pika 1 fjalët "për tregtimin e karburanteve" zëvendësohen me fjalët "për tregtimin e karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës dhe vajrave lubrifikante".

Neni 11

Në nenin 23 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2.a) Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre përgjigjet për:

- zbatimin dhe respektimin e normave dhe të kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse, nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

- zbatimin e kushteve të përcaktuara në lejet apo autorizimet përkatëse, që u janë dhënë personave juridikë, që ato të respektojnë normat teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit;

- respektimin e treguesve cilësorë të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, për parandalimin e abuzimeve dhe të falsifikimeve;

- kryerjen e analizave në laboratorin qendror të Inspektoratit Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre, për sasitë e importuara, para zhdoganimit, për sasitë e prodhuara në vend, si dhe për kontrollin periodik të detyrueshëm të tregut të brendshëm.

Shpenzimet për kontrollin e cilësisë përballohen nga vetë subjektet, në vlerën që caktohet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.

b) Për realizimin e këtyre detyrave Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre bashkëpunon me organet e tjera shtetërore dhe të qeverisjes vendore, që mbulojnë fushën e ndërtimit, të rendit publik, të veprimtarisë tregtare, të mbrojtjes nga zjarri dhe të ruajtjes së mjedisit.

c) Rregullat për organizimin, funksionimin, financimin dhe administrimin e të ardhurave nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 12

Në fund të nenit 24 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kontrolli i treguesve cilësorë për zhdoganimin e mallit bëhet nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre.”.

Neni 13

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 25

Sanksionet

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

a) Për shkelje të nenit 8 masa e gjobës është nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë.

b) Për mosrespektim të sasisë së rezervës të sigurisë dhe të afateve të plotësimit të tyre, sipas nenit 9, masa e gjobës është deri në 50 për qind e vlerës së sasisë së produktit, që mungon nga kuota e përcaktuar si rezervë sigurie.

c) Për shkelje të nenit 12 pikat 5 e 6 masa e gjobës është nga 800 000 lekë deri në 1 000 000 lekë për secilën, veç e veç, nga pikat e lartpërmendura.

ç) Për shkelje të nenit 14 pika 5 masa e gjobës është nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë.

d) Për shkelje të nenit 14 pika 6 masa e gjobës është nga 800 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.

dh) Për shkelje të nenit 14 pika 9 masa e gjobës është nga 500 000 lekë deri në 700 000 lekë.

e) Për shkelje të nenit 14 pika 12 subjekti gjobitet:

i) në masën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë kur mbush dhe tregton bombola të gazit të lëngshëm të naftës të pakolauduara;

ii) në masën nga 100 000 lekë deri në 200 000 lekë kur vë në qarkullim bombola me gaz të lëngshëm të naftës, që nuk kanë identitetin e shoqërisë (ngjyra, marka, tapa e stampuar) ose kur ato janë nën peshën e deklaruar;

iii) në masën nga 500 000 lekë deri në 700 000 lekë kur subjekti bën mbushje të bombolave të gazit të lëngshëm jashtë impianteve të pajisura me lejen përkatëse.

ë) Për shkelje të nenit 15 pika 1 paragrafi i parë masa e gjobës është nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë.

f) Për shkelje të nenit 15 pika 3 paragrafi i parë për secilin detyrim veç e veç dhe paragrafi i dytë, për dorëzimin e marrëveshjes në afat, si dhe për shkelje të pikave 4 e 6 masa e gjobës është nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë.

g) Për shkelje të nenit 15 pika 7 masa e gjobës është nga 70 000 lekë deri në 100 000 lekë.

gj) Për shkelje të nenit 16 pika 3 masa e gjobës është nga 100 000 lekë deri në 200 000 lekë.

h) Për shkelje të nenit 16 pika 4 masa e gjobës është nga 30 000 lekë deri në 50 000 lekë.

i) Për mosrespektim të kushteve dhe të normave teknike në instalimet, impiantet dhe pajisjet masa e gjobës është:

- nga 700 000 lekë deri në 1 000 000 lekë për rafineritë e naftës, impiantet e përpunimit, naftësjellësit e gazsjellësit, si dhe instalimet bregdetare;

- nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë për shoqëritë e tregtimit me shumicë;

- nga 200 000 lekë deri në 300 000 lekë për stacionet e shitjes së karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse.

j) Ushtrimi i veprimtarisë pa leje ose pa autorizim, konform dispozitave të këtij ligji përbën shkelje dhe subjekti gjobitet si më poshtë:

- i) nga 4 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë për rafineritë e naftës, impiantet e përpunimit, naftësjellësit e gazsjellësit, instalimet bregdetare dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë;

- ii) nga 700 000 lekë deri në 1 000 000 lekë për stacionet e shitjes së karburanteve dhe stacionet e njësitë e shitjes së lëndëve djegëse.

Masa e gjobës, e parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, jepet nga Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve, kurse të gjitha gjobat e tjera jepen nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre.

2.1. Në rast përsëritjeje të shkeljeve të mësipërme ose të moszbatimit të sanksioneve të dhëna për këto shkelje, organi përgjegjës ka të drejtën e bllokimit të veprimtarisë së subjektit deri në 30 ditë, duke pezulluar veprimin e lejes së koncesionit, lejes së përpunimit, lejes së tregtimit apo të autorizimit.

2.2. Në rast mosplotësimi nga subjekti të kushtit të bllokimit të përkohshëm ose të përsëritjes, qoftë edhe të njërës prej shkeljeve të mësipërme, organi që vendos sanksionin i propozon organit përgjegjës heqjen e lejes së koncesionit, lejes së përpunimit, lejes së tregtimit apo të autorizimit përkatës për ushtrimin e veprimtarisë.

3. Të ardhurat e përfituara nga gjobat e vëna ndahen si më poshtë:

- a) 10 për qind organit që vendos gjobën;

- b) 90 për qind Buxhetit të Shtetit.

Mënyra e përdorimit të këtyre të ardhurave përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

4. Ankimi kundër vendimit të dënimit me gjobë bëhet në përputhje me ligjin nr.7679, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4221, datë 5.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9219, datë 8.4.2004

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7875, DATË 23.11.1994 "PËR
MBROJTJEN E FAUNËS SË EGËR DHE GJUETINË"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7875, datë 23.11.1994 "Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë", bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave ngrihet Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër dhe Gjuetinë, për të lehtësuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore.

Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër dhe Gjuetinë ka për detyrë:

- a) miratimin e programeve për zhvillimin e faunës së egër dhe të veprimtarisë së gjuetisë;
- b) miratimin e planeve vjetore të mbarështimit të faunës së egër;
- c) miratimin e projekteve për zhvillimin e faunës së egër;
- ç) miratimin e kalendarit të gjuetisë;
- d) kontrollin e kryerjes së detyrave nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor për ruajtjen e faunës së egër dhe realizimin e veprimtarisë së gjuetisë.

Përbërja dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar për Faunën e Egër dhe Gjuetinë përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit."

Neni 2

Në paragrafin e parë të nenit 7, pas fjalëve "pavarësisht nga pronësia" shtohen fjalët "publike ose private".

Neni 3

Në nenin 8 shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) zona të rezervuara për gjueti".

Neni 4

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë fjalët "rezervatet e gjuetisë" zëvendësohen me fjalët "zonat e rezervuara për gjueti".

2. Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

"Miratimi i këtyre zonave bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Pyjeve dhe Kullotave."

Neni 5

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 9/1

Të drejtat e pronësisë mbi fondin e gjuetisë ushtrohen pa cenuar funksionet ekologjike dhe të zhvillimit të faunës së egër.

Të drejtat dhe detyrimet e pronarëve privatë e publikë dhe të shoqatave të gjuetarëve për administrimin e fondit të gjuetisë dhe kryerjen e veprimtarisë së gjuetisë sportive e turistike përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit."

Neni 6

Në paragrafin e dytë të nenit 11, emërtimi "Komitetin e Ruajtjes e të Mbrojtjes së Mjedisit" zëvendësohet me emërtimin "Ministrinë e Mjedisit".

Neni 7

Në nenin 12, emërtimi "Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave" zëvendësohet me emërtimin "Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër dhe Gjuetinë".

Neni 8

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14

Për ruajtjen, administrimin dhe rritjen e faunës së egër, shteti nxit investimet private në pjesë të fondit kombëtar të gjuetisë, në pronësi publike e private, për mbarështimin e faunës së egër, për argëtim, çlodhje, gjueti dhe për veprimtari biznesi, pa cenuar vlerat dhe funksionet e tyre.

Dhënia në përdorim e pjesëve të fondit publik të gjuetisë, për qëllimet e caktuara në paragrafin e parë të këtij neni, bëhet vetëm në bazë të rregullave dhe të procedurave, të përcaktuara nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit."

Neni 9

Neni 22 shfuqizohet.

Neni 10

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 23

Personat juridikë ose fizikë nuk mund ta ushtrojnë veprimtarinë e mbarështimit të faunës së egër ose dhe të gjuetisë sportive e turistike, përveç atyre që zotërojnë të drejtat e siguruar nga ky ligj dhe që janë të pajisur me lejet përkatëse.

Të drejtat, që sigurohen nga leja e ushtrimit të veprimtarisë, nuk mund të transferohen ose t'u jepen personave të tjerë.

Pronarët e tokës private lejojnë ushtrimin e gjuetisë sportive e turistike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet e tjera nënligjore. Marrëdhëniet dhe rregullat e ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë në pronë private caktohen me rregullore të veçantë të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave është autoriteti që lëshon lejet vjetore të gjuetisë."

Neni 11

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 26

Veprimtaria e gjuetisë ushtrohet nga shtetasi që:

- a) ka mbushur moshën 18 vjeç;
- b) ka kaluar testin e hartuar sipas rregullave të caktuara nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit;
- c) është pajisur me lejen për ushtrimin e gjuetisë;
- ç) është anëtar i shoqatave të gjuetarëve;
- d) përmbush detyrimet që rrjedhin nga ligji "Për armët".

Neni 12

Paragrafi i dytë i nenit 28 ndryshohet si më poshtë:

"Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, për arsye të veçanta ekologjike, për specie që paraqesin rrezik zhdukjeje ose që janë të kërcënuara për t'u zhdukur, në gjendje ekologjike të rënduar dhe në raste fatkeqësish natyrore, ndalon veprimtarinë e gjuetisë në të gjithë territorin e vendit ose në disa zona të caktuara."

Neni 13

Pas nenit 29 shtohet neni 29/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 29/1

Pas përfundimit të sezonit të gjuetisë, nga organet e rendit publik, në bashkëpunim me ato pyjore, bëhet, detyrimisht, vulosja e armëve të gjahut, të cilat zhvulosen para fillimit të sezonit pasardhës, kur përdoruesit kanë shlyer taksat dhe tarifat e caktuara dhe kur nuk kanë shkelur dispozitat ligjore, që rregullojnë mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë.

Procedurat e vulosjes së armëve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit."

Neni 14

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 31

Drejtoria e shërbimit pyjor në rreth drejton, organizon, kontrollon dhe përgjigjet për mbrojtjen e faunës së egër e për miradministrimin e saj në të gjithë fondin e gjuetisë.

Personat juridikë dhe fizikë, që kanë në pronësi pjesë të sipërfaqeve që ndodhen brenda fondit të gjuetisë, mund t'i administrojnë dhe përdorin këto sipërfaqe vetëm sipas kërkesave të planit të mbarështimit të faunës së egër dhe në rastet kur rritja e kafshëve dhe e shpendëve të egra bëhet prej tyre. Ata nuk kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë e gjuetisë ose të lejojnë kryerjen e kësaj veprimtarie (në pronat e tyre private) nga personat e tjerë, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor."

Neni 15

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 36

Organet e shërbimit pyjor, Policia e Shtetit, policia bashkiake dhe komunale, Inspektorati i Mjedisit dhe organet tatimore e doganore kanë të drejtë të pezullojnë e të bllokojnë veprimtarinë e subjekteve juridike dhe fizike, që kryejnë veprimtari gjuetie, përpunojnë e tregtojnë lloje ose prodhime të faunës së egër (lëkurë, pendë, mish, vezë, trofe ose dhe specie të gjalla apo të vrara), nëse ata nuk janë të pajisur me lejen përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave dhe kur veprimtaritë e biznesit janë të licencuara nga organet përgjegjëse, si dhe bëjnë sekuestrimin e mjeteve, të armëve të gjahut, të specieve të vrara dhe të trofeve."

Neni 16

Në nenin 38 shtohet shkronja "l" me këtë përmbajtje:

"l) për vrasjen, kapjen tregtimin ose mbajtjen e llojeve të faunës së egër, të përcaktuara si të rralla ose në rrezik zhdukjeje, të kërcënuara ose të mbrojtura rreptësisht, vendoset gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë dhe në rast përsëritjeje vlera e saj pesëfishohet."

Neni 17

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 39

Vendimi për kundërvajtjet administrative merret në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të procesverbalit.

Kundërvajtësi ka të drejtën e ankimimit, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, te Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Pyjeve dhe i Kullotave dhe më pas ka të drejtën t'i drejtohet gjykatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 18

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 40

Shkelja e dispozitave të këtij ligji, kur pasojat materiale janë të rënda dhe përbëjnë rrezik ekologjik për mjedisin rrethues dhe jetën e kafshëve e të shpendëve të egra, përbën vepër penale dhe dënohet sipas dispozitave të Kodit Penal.

Mjetet dhe gjithçka tjetër, që shërbejnë për kryerjen e kundërvajtjeve administrative ose të veprës penale dhe çdo përfitim pasuror, i arritur nëpërmjet kundërvajtjes administrative, sekuestrohen dhe kalojnë për llogari të organeve të shërbimit pyjor."

Neni 19

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 42

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, në zbatim të neneve 10 dhe 28 dhe ministritë përkatëse, në zbatim të neneve 5, 9/1, 10, 14, 16, 23 26 dhe 29/1, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji."

Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4222, datë 5.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

VENDIM
Nr.129, datë 15.4.2004

**PËR CAKTIMIN E PAGËS SË ANËTARËVE DHE KRYETARIT TË BORDIT TË ENTIT
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (ERE)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 4 pika 11 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me propozimin e Komisionit të Përhershëm për Ekonominë, Financat dhe Privatizimin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Paga e anëtarit të Bordit të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE) është e barabartë me kategorinë II a (Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme), ndërsa paga e Kryetarit të këtij Bordi është 10 për qind më e lartë se paga e anëtarit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.130, datë 15.4.2004

**PËR CAKTIMIN E PAGËS SË ANËTARËVE DHE KRYETARIT TË KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 21 pika 4 të ligjit nr.9121, datë 27.3.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", me propozimin e Komisionit të Përhershëm për Ekonominë, Financat dhe Privatizimin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Paga e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës është e barabartë me kategorinë II a (Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme), ndërsa paga e Kryetarit të këtij Komisioni është 10 për qind më e lartë se paga e anëtarit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 26.2.2004.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.131, datë 19.4.2004

**PËR KOMISIONIN HETIMOR PARLAMENTAR PËR HETIMIN NË KORPORATËN
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe të nenit 164 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për hetimin në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH).

II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për detyrë hetimin e informacioneve publike dhe të denoncimeve të bëra për problemet dhe detyrat që kryen KESH-i. Në mënyrë të veçantë komisioni hetimor duhet të hetojë rreth informacioneve dhe denoncimeve për menaxhimin e rezervës ujore të sistemit hidroenergjetik, për praktikën e prokurimeve publike, sidomos për shitblerjen e energjisë elektrike nga KESH-i, për praktikën e faturimit të konsumit të energjisë elektrike për konsumatorët privatë, si dhe për aplikimin e regjimit të kufizimeve të energjisë elektrike.

III. Periudha që do të mbulohet nga hetimi është periudha nga data 1 janar 2002 deri në datën 30 prill 2004, por, nëse del e nevojshme, Komisioni mund të hetojë edhe që nga viti 1994.

IV. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga maxhoranca parlamentare dhe 5 nga opozita, si më poshtë:

- | | |
|------------------|-------------------|
| 1. Jemin Gjana | - Kryetar |
| 2. Eduard Alushi | - Zëvendëskryetar |
| 3. Dilaver Qesja | - anëtar |
| 4. Edi Paloka | - anëtar |
| 5. Alfred Çako | - anëtar |
| 6. Jak Ndokaj | - anëtar |
| 7. Ejup Tabaku | - anëtar |
| 8. Flamur Hoxha | - anëtar |
| 9. Lekë Çukaj | - anëtar |
| 10. Kristo Goci | - anëtar |
| 11. Ndue Preka | - anëtar |

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej dy muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit të marrë të gjitha masat administrative të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.270, datë 7.5.2004

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË KOMITETIT SHETËROR TË
MINORITETEVE TË DISA MJEDISEVE, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KËTIJ
KOMITETI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tre apartamente, përkatësisht nr.6, 1+1, me sipërfaqe 50.6 m², shkalla I, nr.9, 2+1 me sipërfaqe 65,9 m², shkalla I dhe nr.21, 2+1, me sipërfaqe 64,7 m², shkalla II, pallati nr.57, bulevardi “Zogu i I”, në përdorim të Drejtorisë së Shërbimeve të Trupit Diplomatik, në varësi të Ministrisë së Punëve të Jashtme, t’i kalojnë në përgjegjësi administrimi Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, për ushtrimin e veprimtarisë.

2. Ngarkohen Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryetari i Komitetit Shtetëror të Minoriteteve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.272, datë 7.5.2004

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERATIVE TË BRAZILIT, PËR
HEQJEN E PJESSHME TË VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE, ZYRTARE OSE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federative të Brazilit, për heqjen e pjesshme të vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare ose të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERATIVE TË BRAZILIT PËR HEQJEN E PJESSHME TË VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, ZYRTARE OSE TË SHËRBIMIT

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federative të Brazilit, më poshtë të quajtura "Palë",

të frymëzuara nga dëshira për të lehtësuar, reciprokisht, hyrjen, kalimin transit dhe qëndrimin e shtetasve të tyre midis të dy vendeve,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e dy vendeve, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, zyrtare ose të shërbimit, janë të përjashtuar nga viza e hyrjes, kalimit transit dhe qëndrimit në territorin e Palës tjetër për një periudhë jo më gjatë e 90 (nëntëdhjetë) ditë.

Neni 2

Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike, zyrtare ose të shërbimit, të cilët janë emëruar si pjesëtarë të një misioni diplomatik apo konsullor në territorin e Palës tjetër, do të lejohen të hyjnë dhe të qëndrojnë në territorin e Palës tjetër gjatë kohës së detyrës së tyre pa pasur nevojë të marrin vizë.

Neni 3

Dispozitat e nenit 2 zbatohen gjithashtu për familjarët e shtetasve të përmendur më lart, ashtu si dhe për personat e varur prej tyre, të cilët i shoqërojnë ata gjatë përdorimit në territorin e Palës tjetër dhe janë mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, zyrtare apo të shërbimit.

Neni 4

Mbajtësit e pasaportave të secilës Palë, të përmendur në nenet 1 deri në 3, mund të hyjnë në territorin e Palës tjetër në të gjitha pikat e hapura për trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve.

Neni 5

1. Palët do të shkëmbejnë në rrugë diplomatike modelet e pasaportave të tyre diplomatike, zyrtare ose të shërbimit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në rastin kur çdonjëra nga Palët do t'i modifikojë këto pasaporta, ajo do t'i përcjellë Palës tjetër modelet e pasaportave të reja, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara se ato të hyjnë në përdorim.

Neni 6

Kjo Marrëveshje nuk paragjykon të drejtën e çdonjërës Palë që të refuzojë hyrjen ose të shkurtojë qëndrimin e shtetasve të Palës tjetër, atëherë kur ajo vlerëson se prania e këtyre personave në territorin e saj është e padëshirueshme.

Neni 7

Për arsye sigurie të rendit publik apo të shëndetit publik, çdonjëra nga Palët mund ta pezullojë përkohësisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në tërësi ose pjesërisht. Ky pezullim do t'i njoftohet Palës tjetër përmes kanaleve diplomatike, sa më parë të jetë e mundur.

Neni 8

1. Shtetasit e të dy Palëve që përfitojnë nga kjo Marrëveshje nuk përjashtohen nga respektimi i ligjeve dhe i rregullave në fuqi në të dy Palët, të cilat kanë të bëjnë me hyrjen dhe qëndrimin e të huajve dhe ata nuk do të kenë të drejtën të punësohen apo të zhvillojnë veprimtari fitimprurëse të çdo lloji natyre gjatë qëndrimit të tyre.

2. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim në ligjet dhe rregullat përkatëse që kanë të bëjnë me hyrjen, daljen, kalimin transit dhe qëndrimin e të huajve.

Neni 9

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar, përderisa njëra nga Palët ta denoncojë atë përmes kanaleve diplomatike. Denoncimi do të bëhet i vlefshëm 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së këtij njoftimi.

Neni 10

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e notës së dytë diplomatike, me anë të së cilës njëra Palë njofton tjetrën se janë përmbushur të gjitha kërkesat e legjislacionit përkatës kombëtar që kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi.

Bërë në Brazilia, në datën 23 mars 2004, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, portugeze dhe angleze, secila e vlefshme në mënyrë të barabartë.

Në rast mosmarrëveshje për interpretimin, do të jetë i vlefshëm teksti në anglisht.

VENDIM

Nr.279, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Tiranës, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:

a) zona e fushës Kamëz-Zallher (TRK-1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1475 ha;

b) zona e fushës Paskuqan-Kashar-Prezë dhe Gjokaj-Vorë-Marikaj (TRK-6,17), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 2900 ha;

c) zona e fushës Petrelë-Arbanë-Stërmas (TRK-20), që kullon me të rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1050 ha;

ç) zona e fushës së Baldushkut (TRK-21), me sipërfaqe 430 ha;

d) zona e fushës së lumit Erzen (TRK-26,29,32,39), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1014 ha;

dh) zona e fushës Bërzhitë-Fikas (TRK-47,48), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 225 ha;

e) pendët mbrojtëse nga përmytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

ë) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:
- a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;
 - b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;
 - dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.
4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.
5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.
6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.280, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË DURRESIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Durrësit, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.
2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:
- a) zona e fushës Hamallaj (DRK-1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1770 ha;
 - b) zona e fushës së Kënetës së Durrësit dhe Shkozetit (DRK-4,11), që kullon me ngritje mekanike me hidrovor, me sipërfaqe 3700 ha;
 - c) zona e fushës së Sukthit, Tarinit, Armadhit, Topanasë dhe Rushkullit (DREK-2,3,6,8,9), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 4710 ha;
 - ç) zona e fushës Shënavlash, Fllakë, Katund i Ri (DRK-5, 14), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 3500 ha;
 - d) zona e fushës së lumit Erzen (DKR-7), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1000 ha;
 - dh) zona e fushës Metallaj, Maminas (DRK-10), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 700 ha;
 - e) zona e fushës Ishëm-Gjuricë (DRK-12, 13), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 320 ha;
 - ë) pendët e mbrojtëses nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;
 - f) sistemi i mbrojtjes së tokave nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.
3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:
- a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;
 - b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

- ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;
 - dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.
 - 4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.
 - 5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.
 - 6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM **Nr.282, datë 16.4.2004**

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Shkodrës, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.
2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:
 - a) zona e fushës së Mbishkodrës (SHK-1), që kullon me rrjedhje të lirë në liqenin e Shkodrës, me sipërfaqe 2500 ha;
 - b) zona e fushës së Mbishkodrës (SHK-2), që kullon me rrjedhje të lirë në lumin Kir, me sipërfaqe 2600 ha;
 - c) zona e fushës Oblikë-Ana e Malit (SHK-3), që kullon me rrjedhje të lirë në lumin Bunë, me sipërfaqe 1450 ha;
 - ç) zona e fushës së Zadrimës (SHK-4, SHK-5), që kullon me rrjedhje të lirë në lumin Drini i Vjetër dhe në lumin Gjadër, me sipërfaqe 3740 ha;
 - d) zona e fushës Nënshkodër-Trush (Shk-6), që kullon me rrjedhje të lirë në Vilun-Mertemzë, me sipërfaqe 9160 ha;
 - dh) zona e fushës së Velipojës (SHK-7), që kullon me ngritjen mekanike me hidrovor, me sipërfaqe 3200 ha;
 - e) zona e fushës Gruemirë-Koplik-Bajzë (MAK-1), që kullon me rrjedhje të lirë në liqenin e Shkodrës, me sipërfaqe 6510 ha;
 - ë) zona e fushës Bajzë-Koplik (MAK-2, MAK-3), që kullon me rrjedhje të lirë në liqenin e Shkodrës, me sipërfaqe 1890 ha;
 - f) pendët mbrojtëse nga përmytja e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;
 - g) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.
3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:
 - a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;
 - b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;
 - dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.
 5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.
 6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.283, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Lezhës, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.
 2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:
 - a) zona e fushës Mat-Lezhë (LEK-1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1500 ha;
 - b) zona e fushës Mat-Lezhë (LEK-2), që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 5000 ha;
 - c) zona e fushës së Zadrimës (LEK-3), që kullon me rrjedhje të lirë, një sipërfaqe 6500 ha dhe me ngritje mekanike, një sipërfaqe 500 ha;
 - ç) zona e fushës së Kakariqit (LEK-4), që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 2250 ha;
 - d) zona e fushës së Ishull Shëngjinit (LEK-5), që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 700 ha;
 - dh) pendët mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;
 - e) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.
 3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:
 - a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;
 - b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;
 - dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.
 4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.
 5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.
 6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.284, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT
KRUJË-KURBIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit në kullimit të zonën e shërbimit të kullimit Krujë-Kurbin, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:

a) zona e fushës që kullon me KUL, Thumanë-Borizanë (KRK-1, KRK-2), me sipërfaqe 21300 ha;

b) zona e kënetës Borizanë-Thumanë (KRK-3), që kullon me ngritje mekanike, me një sipërfaqe 1591 ha;

c) zona e fushës që kullon me përroin Bardharë (KRK-4), me sipërfaqe 1499 ha;

ç) zona e fushës Bacung-Dollakë-Tapizë (KRK-5, KRK-6), me sipërfaqe 3714 ha;

d) zona e fushës Bubq-Mallkuc (KRK-7), me sipërfaqe 2567 ha;

dh) zona e fushës së Thumanës, që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 8310 ha;

e) zona e fushës që kullon me KUL Gjormë-Zheje, Mamurras-lumi Drojë dhe KUL Laç-Milot (LAK-2, LAK-3, LAK-4), me sipërfaqe 1193 ha;

ë) zona e fushës që kullon me KK-1, Shullaz-Fushë, Milot-Gurrëz-ALK (LAK-5), me sipërfaqe 1459 ha;

f) pendët mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe kanalet e ujërave të larta;

g) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 2 (dy) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

b) 2 (dy) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;

dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.285, datë 16.4.2004

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.490, DATË 16.10.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E BORDIT TË KULLIMIT TË RRETHIT KAVAJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.490, datë 16.10.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Titulli të ndryshohet si më poshtë vijon:
“Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Peqin-Kavajë”.
 2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:
“1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Peqin-Kavajë, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.”.
 3. Pas pikës 2.4 të pikës 2, të shtohen pikat me këtë përmbajtje:
“2.5. zona e fushës së Peqinit (PEK-1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 820 ha;
2.6. zona e fushës Darsi Vashaj (PEK-2), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1045 ha;
2.7. zona e fushës së Bishqemit (PEK-3), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 50 ha;
2.8. pendët mbrojtëse nga përmbytjet e detit, të lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;
2.9. sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.”.
 4. Në pikën 3 të bëhen këto ndryshime dhe kjo shtesë:
- Në shkronjën “a” nga “2 (dy) përfaqësues” të bëhet “3 (tre) përfaqësues”.
- Në shkronjën “b” nga “3 (tre) përfaqësues” të bëhet “4 (katër) përfaqësues”.
- Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d. 1 (një) përfaqësues i biznesit me, veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.”.
 5. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:
“4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.286, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Elbasanit, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:
- a) zona e fushës Kryezjarr-Shirgjan-Cërrik-Shals (ELK-22, ELK-1, ELK-40), që kullon me sipërfaqe 3688 ha;
 - b) zona e fushës Labinot-Elbasan-Bradashesh (ELK-2), që kullon një sipërfaqe 1365 ha;
 - c) zona e fushës Floq-Sulovë (ELK-18, ELK-3), që kullon një sipërfaqe 1020 ha;
 - ç) zona e fushës së Funarit (ELK-4), që kullon një sipërfaqe 50 ha;
 - d) zona e fushës së Fushë-Buall-Shushicë-Hajdaraj (ELK-5), që kullon një sipërfaqe 590 ha;
 - dh) zona e fushës Papër (ELK-7, ELK-14, ELK-11), që kullon një sipërfaqe 83;
 - e) zona e fushës Broshkë-Valas (ELK-8, ELK-9), që kullon një sipërfaqe 193 ha;
 - ë) zona e fushës Malasej-Shtërmën-Gostimë-Shtëpaj (ELK-15, ELK-16, ELK-20), që kullon një sipërfaqe 247 ha;
 - f) zona e fushës së Dumresë [ELK (B)-2, ELK(B)-3, ELK (B)-5, ELK (B)-7, ELK (B)-9, ELK (B)-9, ELK (B)-13], që kullon një sipërfaqe 1213 ha;
 - g) zona e fushës Domosdovë-Librashd (LBK-1), që kullon një sipërfaqe 800 ha;
 - gj) pendët mbrojtëse nga përmbytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;
 - h) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të kanaleve.
3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:
- a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;
 - b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;
 - dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.
4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5 000 (pesë mijë) lekë.
5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.
6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.287, datë 23.4.2004

**PËR LEJIMIN E INSTITUCIONEVE BUXHETORE TË PËRDORIN PROCEDURËN
“PROKURIM I DREJTPËRDREJTË” PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË MJETEVE
TË TYRE MOTORIKE PËR PËRGJEGJËSITË NDAJ PALËVE TË TRETA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e institucioneve buxhetore që, për fondet limit të miratuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2004, të përdorin procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë” me INSIG sh.a. për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të tyre motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.
2. Primi që INSIG, sh.a. do të arkëtojë nga institucionet buxhetore, të jetë vlera e primit të pastër, shtuar vlerën e shpenzimeve minimale administrative, të përcaktuara me urdhër të Ministrisë të Financave.

3. Ngarkohen drejtuesit e institucioneve buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.288, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe për kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Fierit, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:

a) zona e fushës Cakran-Frakull dhe lugina e Vjosës (FRK-1), që kullon një sipërfaqe 4811 ha;

b) zona e fushës së Hoxharës (FRK-II), që kullon me ngritje mekanike me hidrovor një sipërfaqe 9900 ha;

c) zona e fushës së Hoxharës (FRK-III), që kullon me ngritje mekanike me hidrovor një sipërfaqe 7200 ha;

ç) zona e fushës Roskovec-Hoxharë (FRK-IV), që kullon me rrjedhje të lirë një sipërfaqe 10 136 ha dhe me ngritje mekanike me hidrovor një sipërfaqe 790 ha;

d) zona e fushës së Libofshës (FRK-V), me sipërfaqe 6180 ha, nga të cilat 3480 ha kullohen me ngritje mekanike me hidrovorin e Karavastasë;

dh) zona e fushës që kullon me kolektorin Bitaj (FRK-VI), me rrjedhje të lirë në një sipërfaqe 2870 ha;

e) zona e fushës së luginës së lumit Gjanicë (FRK-VII), që kullon me rrjedhje të lirë një sipërfaqe 591 ha;

ë) zona e fushës së luginës së lumit Seman (FRK-VIII), që kullon me rrjedhje të lirë një sipërfaqe 184 ha;

f) zona e fushës Kute-Çorrush (MKK-1,2), që kullon me rrjedhje të lirë një sipërfaqe 771 ha;

g) zona e fushës Hekal-Romes (MKK-3,4), që kullon me rrjedhje të lirë një sipërfaqe 300 ha;

gj) zona e fushës Mollas-Damës (MKK-4,5), që kullon me rrjedhje të lirë një sipërfaqe 490 ha;

h) pendët mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

i) sistemi i mbrojtjes së tokave nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;

- dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari, brenda zonës së shërbimit të kullimit.
4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.
5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.
6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.289, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË VLOORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujtitjen dhe kullimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Vlorës, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.
2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:
- a) zona e fushës së Myzeqesë (VLK-1,2,3), që kullon 6650 ha, nga të cilat me ngritje mekanike me hidrovor 5 550 ha dhe me rrjedhje të lirë 11 00 ha;
- b) zona e fushës Llakatund-Armen (VLK-4,5), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 2800 ha;
- c) zona e fushës Dukat-Tragjas (VLK-6), që kullon një sipërfaqe 1800 ha, nga e cila 400 ha kullon me ngritje mekanike me hidrovor;
- ç) zona e fushës së lumit Shushicë nga Drashovica deri në Kallarat (VLK-7), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 4010 ha;
- d) zona e fushës Sevaster-Shkozë-Dushkarat-Karburnarë-Romes (VLK-8), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1000 ha;
- dh) zona e fushës së Petes, Harvalasë, Peshkëpi-Vllahisë, Trevllazër-Cergovisë (VLK-9), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1750 ha;
- e) zona e fushës së Bregut, Qeparo-Himarë-Vuno-Pilur (VLK-10), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 420 ha;
- ë) pendët mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe ato bregdetare përfshi dhe argjinaturën kufizuese të liqenit të Nartës, si dhe të kanaleve të ujërave të larta;
- f) sistemi i mbrojtjes së tokave nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.
3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:
- a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;
- b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
- c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
- ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
- d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;
- dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari, brenda zonës së shërbimit të kullimit.
4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.
6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.290, datë 30.4.2004

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 66 të ligjit nr.7623, datë 13.10.1992 “Për pyjet dhe Policinë e Shërbimit Pyjor”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare për zbatimin e kësaj strategjie, në vlerën prej 280 000 000 (dyqind e tetëdhjetë milionë) lekësh, të fillojnë në vitin 2005 dhe të përballohen nga:

- Buxheti i Shtetit;
- llogaria e të ardhurave të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe të Kullotave;
- financime të huaja.

3. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Financave, Ministri i Rendit Publik, Ministri i Mjedisit, Ministri i Ekonomisë, Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Arsimit dhe i Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr.5, datë 19.1.2004

“PËR MONITORIMIN E KONTRATAVE TË QIRAVE DHE ENFITEOZËS, VLERËSIMIN E INVESTIMEVE NË OBJEKTET E NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE APO INSTITUCIONEVE SHTETËRORE, TË DHËNA ME QIRA OSE ENFITEOZË, MONITORIMIN E TYRE DHE APLIKIMIN E KOEFICIENTËVE TË ULJES TË ÇMIMIT TË QIRASË ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8884, datë 22.4.2002 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit" dhe të ligjit nr.8333, datë 23.4.1998, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.315, datë 24.4.2003 “Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”, Ministria e Ekonomisë

UDHËZON:

1. Ministria e Ekonomisë drejton monitorimin e kontratave, kur pasuria (ndërtesa, trualli dhe makineria) e ndërmarrjes, shoqërisë apo institucionit shtetëror jepet me qira dhe enfiteozë.

Monitorimi ushtrohet:

a) nga ministria e linjës apo organi vendor që ka në varësi administrative ndërmarrjen, shoqërinë apo institucionin që ka dhënë objektin me qira apo enfiteozë;

b) nga drejtoria e ndërmarrjes, shoqërisë apo institucionit shtetëror, që ka në administrim objektin e dhënë me qira apo enfiteozë;

c) nga dega e shoqërisë publike për të gjitha kontratat e qirasë të lidhura nga institucionet shtetërore në prefekturën e tyre.

2. Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike në Ministrinë e Ekonomisë bën çdo vit monitorimin e realizimit të treguesve të investimeve dhe të nivelit të punësimit, krahasuar me planbiznesin, i cili është pjesë përbërëse e kontratës së qirasë apo enfiteozës.

3. Degët e shoqërive publike në prefektura dërgojnë çdo 3 muaj në Ministrinë e Ekonomisë dhe në organet e varësisë administrative informacionin, sipas matricës bashkëlidhur, për kontratat e qirave të objekteve shtetërore brenda prefekturës, si dhe në fund të vitit informacion për zbatimin e kushteve kontraktore dhe realizimin e investimeve dhe të nivelit të punësimit nga subjektet qiramarrëse për kontratat e lidhura nga Ministria e Ekonomisë.

4. Ndërmarrjet, shoqëritë dhe institucionet që kanë në administrim objektin e dhënë me qira apo enfiteozë dërgojnë çdo 3 muaj:

Në Ministrinë e Ekonomisë informacion për derdhjet e detyrimeve për kontratat e qirasë të lidhura në Ministrinë e Ekonomisë të shoqëruar a me kopjet e mandatarkëtimeve të qirave të bëra nga subjektet qiramarrëse, mandatpagesat për shpërndarjen e të ardhurave të qirave sipas kapitullit V të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 24.4.2003 “Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore” dhe në fund të vitit informacion për zbatimin e kushteve kontraktore dhe realizimin e investimeve dhe të nivelit të punësimit nga subjektet qiramarrëse, duke mbajtur aktverifikimin apo procesverbalin përkatës për realizimin e detyrimeve të marra përsipër nga qiramarrësi.

Në organet e varësisë administrative informacion për derdhjet e detyrimeve për kontratat me sipërfaqe 201 deri 500 m² dhe në fund të vitit informacion për zbatimin e kushteve kontraktore dhe realizimin e investimeve dhe të nivelit të punësimit nga subjektet qiramarrëse.

Në degën e shoqërisë publike informacion për zbatimin e detyrimeve kontraktore për të gjitha kontratat e qirave, pavarësisht nga sipërfaqet.

Monitorimi i vlerës për kontratat e qirasë

Tregues të uljes së tarifës së qirasë janë: realizimi i nivelit të punësimit dhe i investimeve sipas kapitullit IV “Nxitja e biznesit” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.315, datë 24.4.2003 “Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”. Realizimi i këtyre treguesve aplikohet si shumë e tyre në uljen e tarifës së qirasë.

Shembull:

- Subjekti qiramarrës ka kryer një investim prej 600 mijë USD dhe për këtë nivel ulja e vlerës është – 20%;

- niveli i punësimit është 100 punonjës, ulja e vlerës së qirasë është 30%;

- totali i uljes së vlerës së qirasë nga realizimi i dy treguesve është 50%.

Ulja e tarifës prej kryerjes së investimeve shërben deri në përfundim të kontratës së qirasë, kurse prej nivelit të punësimit kërkohet paraqitja e vërtetimit të punësimit çdo vit prej degës së Sigurimeve Shoqërore.

Realizimi i nivelit të punësimit mesatar vjetor

Me kërkesë të qiramarrësit, ky tregues miratohet një herë në vit, sipas nivelit të punësimit mesatar vjetor, të vërtetuar nga dega e sigurimeve Shoqërore.

Realizimi i nivelit të investimeve

Ky tregues miratohet sipas dokumentacionit të dërguar nga subjektet qiramarrëse, të vërtetuar nga ekspertët kontabël. Dokumentacioni bazë për njohjen e investimeve të kryera në zbatim të kontratës së qirasë apo enfiteozës për efekt të aplikimit të koeficienteve reduktues e në tarifat e qirasë është:

1. Kërkesa e subjektit për ulje të tarifës së qirasë nga realizimi i treguesit të investimit dhe treguesit të punësimit.

2. Pasqyra përmbledhëse e vlerave të investimeve e detajuar për investime në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, duke përfshirë dhe TVSH-në.

3. Pasqyrë e detajuar për investimet në pasuri të paluajtshme sipas situacioneve të punimeve, vlerat e tyre, TVSH-ja e llogaritur, pagesat e situacioneve dhe të TVSH-së, të cilat i bashkëlidhen pasqyrës.

4. Pasqyrë e detajuar për investimet në pasuri të luajtshme, të vërtetuar me fatura blerje, fatura doganore, TVSH-ja e paguar, të cilat i bashkëlidhen pasqyrës.

5. Raporti i ekspertit kontabël për vërtetësinë e investimeve të kryera. Eksperti kontabël kur e sheh të nevojshme mund të kërkojë të vërtetohen investimet në pasuri të paluajtshme nga ekspertë vlerësues të pasurisë.

6. Vërtetim nga dega e tatimeve për shlyerje të TVSH-së për investimin e kryer.

7. Miratim nga ndërmarrja, shoqëria apo institucioni që ka dhënë objektin me qira apo enfiteozë se subjekti qiramarrës ka kryer investimin përkatës dhe sigurimin shoqëror.

8. Bilancet financiare të miratuara në degën e tatimeve, kur në to janë paraqitur investimet e kryera.

Për objektet e dhëna me qira në zonat verilindore, kriteret lehtësuese për realizimin e punësimit dhe investimeve zbatohen duke u shumëzuar me koeficientin 1.5.

MINISTRI I EKONOMISË
Anastas Angjeli

RREGULLORE

MBI DETYRAT, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMIN E DEGËVE TË SHOQËRIVE PUBLIKE PRANË PREFEKTURAVE

Degët e shoqërive publike pranë prefekturave, organizohen dhe funksionojnë të përfshira në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Ekonomisë. Pagat e punonjësve të degëve do të jenë ato të parashikuara në lidhjen përkatëse të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.726, datë 21.12.2000 për punonjësit e prefekturave dhe urdhrin të përbashkët nr.9, datë 1.10.2002 ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale "Për pagat e punonjësve të sistemit të Ministrisë së Ekonomisë".

Të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të degëve të shoqërive publike rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë".

Emërimi dhe shkarkimi i punonjësve bëhet nga Ministri i Ekonomisë.

Degët e shoqërive publike kanë këto funksione dhe kompetenca:

Degët e Shoqërive publike në prefektura kontrollojnë procedurat e privatizimit të pronës publike në territorin administrativ të prefekturës përkatëse, duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Administrata e subjekteve publike dhe jopublike, ku shteti është pronar, ortak apo aksionar, është e detyruar t'u vënë në dispozicion degëve të shoqërive publike, dokumentacionin e privatizimit të aseteve, kontratat e qiradhënies apo enfiteozës dhe dokumente të tjera, objekt verifikimi, kontrolli e vlerësimi.

Degët e shoqërive publike, bashkërendojnë punën me administratën e organeve të qeverisjes vendore, të ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërive tregtare me kapital pjesërisht apo tërësisht shtetëror, për miradministrimin e pronës publike.

Kontrollojnë metodikën e ndjekur, saktësinë e veprimeve të kryera për vlerësimin e pronës publike për privatizim, si dhe përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe përcjellin dokumentacionin, sipas rastit: në organet e vartësisë administrative apo në degët e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit pranë prefekturës.

Ndihmojnë dhe udhëzojnë administratën e ndërmarrjeve apo të shoqërive tregtare për plotësimin e dokumentacionit të vlerësimit të pronës publike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Degët e shoqërive publike raportojnë për zbatimin e detyrave të mësipërme sa herë që kërkohet nga drejtoritë përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë (në Drejtorinë e Privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive të Vogla e të Mesme dhe Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike), por jo më vonë së data 10, pas mbylljes së tremujorit.

II. DETYRAT E DSHP-VE PËR QIRADHËNIEN DHE MONITORIMIN E KONTRATAVE TË QIRASË E TË ENFITEOZËS PËR PASURITË PUBLIKE

1. Ndjek monitorimin e kontratave të qirasë që janë lidhur nga subjektet publike në prefekturë.

2. Ndjek zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në hartimin e kontratave të qirasë, duke bërë kontrollin e objektit të dhënë me qira, varësinë administrative të tij, vlerësimin e qirasë për sipërfaqen e ndërtesave dhe të truallit, makineri-pajisjet etj.

3. Merr informacion çdo 3-mujor për ecurinë e kontratave nga organet që kanë dhënë objekte me qira për realizimin e kushteve të kontratës, pagesave, shlyerjeve të debive ndaj shtetit etj.

4. Jep informacion çdo 3 muaj në Ministrinë e Ekonomisë për monitorimin e kontratave të qirasë, problemet e konstatuara gjatë monitorimit duke i bërë prezent ato në organet e varësisë administrative.

5. Administrojnë një kopje të kontratave të qirave për prefekturën përkatëse.

III. PËRDORIMI I FONDEVE BUXHETORE DHE MARRËDHËNIET FINANCIARE

Për të pasur efektivitet në përdorimin e fondeve buxhetore të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me pagesa dhe shërbime për realizimin e detyrave dhe kompetencave të DSHP-ve do të kryhen nga strukturat e miratuara të Ministrisë.

Pagat e punonjësve të DSHP-ve do të përllogariten dhe shpërndahen një herë në muaj mbi bazë të listëprezencave të firmosura nga kryetarët e degëve dhe konfirmohen nga Drejtori i Privatizimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Kur punonjësi për arsye objektive nuk ka mundësi të paraqitet për të tërhequr personalisht pagën, paga do të tërhiqet nga kryetari i degës.

Për plotësimin e kërkesave për materiale dhe shërbime, (shpenzime operative) DSHP-të do të paraqesin kërkesën me shkrim në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve. Ky i fundit pasi i miraton ato i paraqet tek kryetari i Entit Prokurues, për realizimin e tyre sipas procedurave përkatëse të prokurimit. Nuk lejohet të bëhen blerje apo shërbime nga punonjësit e DSHP-ve.

Për shërbimet nga të tretët për energjinë elektrike dhe telefonin fiks do të lidhen kontratat me subjektet përkatëse, të cilat duhet të miratohen nga sektori i buxhet-financës në Ministrinë e Ekonomisë. Faturat e shërbimeve dhe të shpenzimeve do të kontrollohen dhe siglohen nga sektori i buxhetit

Mbi bazën e aseteve që janë në proces privatizimi, DSHP-të duhet të paraqesin planin e shërbimeve të punonjësve, brenda rrethit apo midis rretheve, për periudhën tremujore, mbi bazë të të cilit bëhen autorizimet e firmosura nga Sekretari i Përgjithshëm.

Formulari i urdhërshërbimit do të firmoset nga nëpunësi udhëtues, dhe:

- Për kryetarët e degëve miratohet (firmoset) nga Drejtori i Privatizimit të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme dhe siglohet nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe Sekretari i Përgjithshëm.

- Për specialistët firmoset nga kryetari i degës dhe siglohet nga Drejtori i Privatizimit të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme, Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Kur shërbimi është në fshatrat përreth vendbanimit përfitohet dietë vetëm për distancat e miratuara nga qarku i rrethit ku vepron DSHP-ja.

BAZA LIGJORE QË USHTROJNË DSHP

- Ligji nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarisë private të pavarur dhe privatizimit”, i ndryshuar

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, si dhe procedurat e shitjes”

- Udhëzimi nr.1, datë.9.5.2003 “Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003”

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.195, datë. 20.3.1998 “Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen”

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.197, datë.20.3.1998 “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të objekteve që nuk ka qenë e mundur të shiten”

- Udhëzimi nr.5 datë.15.5.1998 “Në zbatim të vendimi të Këshillit të Ministrave nr.197, datë 20.3.1998”

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.70, datë.11.3.1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”, i ndryshuar

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.315, datë 24.4.2003 “Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive apo institucioneve shtetërore”

- Udhëzimit nr.4, datë 11.6.2003 “Për vendimin e Këshillit të Ministrave nr.315, datë 24.4.2003”

- Udhëzimit nr.5, datë 19.1.2004 “Për monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës, vlerësimin e investimeve në objektet e dhëna me qira dhe enfiteozë, monitorimi i tyre dhe aplikimi i koeficienteve të uljes së çmimit të qirasë”

Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe sektori i buxhetit.

MINISTRI I EKONOMISË
Anastas Angjeli

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

- ♦ *SË SHPEJTI NË BOTIM, INDEKSI TEMATIK DHE KRONOLOGJIK*
- ♦ *PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE*

Doli nga shtypi më 19.5.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë